

## Shqiptaret ne Itali te paret ndër të huaj per sa i perket numrit te rezidenteve dhe jo vetem kaq.

Sipas nje publikimi te Zyrës së Motorizimit Civil mbi patentat e qytetarëve të huaj del se shqiptarët kanë marrë mbi **200 mijë patenta** italiane.

Vete Istituti Italian i Statistikave konfirmon jo vetëm një rritje të konsistueshme të rezidentëve shqiptare me banim të rregullt në Itali por edhe i vë ata në vend të parë nga numri. ata jane gjithashtu edhe në krye të numrit të të huajve në shumë qytete, provinca dhe Rajone të Italisë.

Në fakt,nga **1 janari 2003 në 1 janar 2006** numri i tyre ka kaluar nga **216.258 në 348.318 persona** (196.744 meshkuj dhe 152.096 femra) dhe përbëjnë rreth **13 % të emigrantëve** të huaj rezidente te rregullt në Itali ( numri i përgjithshëm i emigrantëve rezidente në Itali është **2.670.514 persona** ( 1.350.588 meshkuj dhe 1.319.926 femra).

Kjo rritje e numrit te shqiptareve rezidente te ligjshem ne Itali varet nga shume faktorë si :

- **Lindjet:** 33 çdo 100 te sapolindur të huaj gjatë vitit 2004 janë me kombësi shqiptare.
- **Bashkimet familjare** (shqiptarët dhe marokinët janë nacionalitetet që kërkojnë numrin më të madh të bashkimeve familjare)
- Marrja e rezidencës pas **sanatories** se fundit
- **Dekretet e fundit te fluksit** të hyrjes për punë(per vitet 2003-04-05)

Në provincat e Piemontes shqiptarët përbëjnë numrin më të madh në;

- **Cuneo** (8.380 – 25,4 % e të huajve)
- **Asti** (3.442- 25,4 % e të huajve)
- **Alessandria**( 6.216- 25,6 % e të huajve)

Në zona të tjera italiane shqiptarët përbëjnë shumicën në këto Provinca (përqindja e paraqitur është në raport me emigrantët e huaj në atë territor) :

- Varese (8127- 17,6 % ); Pavia (4.856 - 18,4 % ); Bolzano (3.616- 14,2 % ); Trento (4.878- 16,1 % ); Venezia (4.991- 12,6%); Udine: (3.969- 16,4%); Imperia (2381- 19,5%); Savona (4.227- 33,6%); La Spezia (1.652- 33,6 % ); Piacenza (4.447- 20,7%); Parma (4.149- 13,5 % ); Ravenna (4.572- 19,7%); Forlì – Cezena (4.415 – 19,3%); **Rimini** (5.330- 30,6%); Massa Carrara (1.543- 20,8%); Lucca (2.927- 18,9%); Pistoia (7.044- 43,5%); Firenze (13.181- 18,8 % ); Livorno (2260- 17,6%); Pisa (5534- 27,5%); Siena (4.218 – 24,9); Grosseto (1341- 12,7%); Perugia (10.056-21,3%); Terni(2580-21,5%); Pesaro e Urbino (4673- 21,3%); Ancona (4.429-16,3%); Ascoli Piceno (4370- 23,3%); Frosinone(3.405- 29,3%); Teramo (3764- 28,3%);Pescara(1377- 17,8%); Chieti (3462-35,9%); Campobasso(628-21,4%); Foggia (2.451-26,3%); Bari(10.241-46,3%); Taranto (1560-38,5%); Brindisi (2.066- 51,1%); Lecce(2.661-28,,9%); Matera (1.128- 33,4%)

Në Rajonet e Italisë qytetarët shqiptarë rezidentë në Itali janë të parët në numër në Puglia, Trentino Alto Adige, Friuli Venezia Giulia, Toscana, Umbria, Marche, Abruzzo, Basilicata. Në qytetet e mëdha jetojnë rreth **26 %** e shqiptareve te Italisë ndersa rreth **74 %** e tyre jetojnë në qytete dhe komuna më të vogla.

Më poshtë po ju paraqesim rajonet e Italisë dhe nacionalitetin dominues të emigrantëve aty (përqindja e paraqitur është në raport me emigrantët e tjerë në atë rajon) :

- **Piemonte.** Romania: (53.007- 22,9 %)
- **Valle d’Aosta** : Maroku (1.608 – 32,3%)
- **Lombardia:** Maroku (77.206 – 11,6 %)
- **Trentino-** Alto Adige: Shqiperia (8.494 –15,2 %)
- **Veneto:** Maroku ( 43.682 – 13,6% )
- **Friuli – Venezia Giulia:** Shqipëria (10.248- 15,7% %)
- **Liguria:** Ekuadori (14.956- 20,1%)
- **Emilia Romagna** : Maroku (49.960 –17,3%)
- **Toscana:** Shqipëria (47.154- 21,9%)
- **Umbria:** Shqiptarët (12.636- 21,3%)
- **Marche:** Shqipëria (16.952 – 18,6%)
- **Lazio:** Romania (65.507- 23,8%)

- **Abruzzo:** Shqipëria (10.130- 23,1)
- **Molise:** Maroku (756- 17,8%)
- **Campania:** Ukraina (25.207- 27,2%)
- **Puglia:** Shqipëria (18.979- 39%)
- **Bazilikata :** Shqipëria (1.522 – 23,8%)
- **Calabria;** Maroku (8.499-25,4%)
- **Sicilia:** Tunizia (14.584- 19,6%)
- **Sardegna:** Maroku (3.007 – 16,8)

Pertej nivelit numerik, rezulton qe shqiptaret jane ne vend te pare dhe ne proçesin e integritit ne kete vend. Ne Gadishullin Apenin operojne mbi 20.000 firma private me pronare bashkeatdhetaret tane e gjithashtu vlen te permendet fakti qe rreth 1/3 e familjeve shqiptare me banim ne Itali jetojne tashme ne shtepite qe kane ne pronesi.